

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Bajram Mulaku**

I nderuari z. Mualku,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ndërtimin e fabrikës për përpunimin e ujit të pijshëm në fshatin Balincë;
- Rrjetin e ujësjellësit në pjesën perëndimore që përfshin 15 fshatra;
- Furnizimin me ujë të pijshëm për fshatin Dubovc;
- Sigurimin e ujit të pijshëm 24 orë në ditë deri në fund të vitit 2010; (Komisioni Evropian ka nda 3 milion euro për rregullimin e sistemit të ujësjellësit, ka filluar punimi i projektit ideor – dhe premtimi është se do të ketë ujë deri në fund të vitit 2010, 24 orë në ditë).
- Deponimin dhe riciklimin e mbeturinave;
- Rikonstruimin e bezeneve në lumin Sitnicë dhe largimin e mbeturina në urën e lumit Sitnica;
- Ndërtimin e kolektorit përmes lumit, i cili do të pastroj ndotjen;
- Përkrahjen e fermerëve dhe prodhimtarisë bujqësore, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura kodrinore-malore;
- Themelimin e Entit të Patates;
- Mbjelljen e fidanëve;
- Projektim detajor për rregullimin e hapësirës së gjelbër tek ura e gurit;
- Ndërtimin e parkut të biznesit (ku do të hapen 2000 vende të reja të punës);
- Rregullimin e dy shesheve "Dëshmorët e Kombit" dhe "Hasan Prishtina";
- Për bashkësinë vendore të Dubovcit ( fshatrave të Drenicës që i përkasin Komunës së Vushtrrisë) veç se janë ndarë 400 000 euro për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit ;
- Ndërtimin e rrugës në Samadraxh më së largu deri në vitin 2011;
- Largimin e tregut pranë hamamit si dhe restaurimin e kalasë;
- Hulumtime arkeologjike dhe restaurime për mbrojtjen e monumenteve historike (janë ndarë 100,000 euro).

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN)